



Kompania Lufra, pjesë e LUFRA FOODS, që prodhon dhe shpërndan markat e veta shumë të suksesshme si Lufra, Tido, Tradita, Beneta dhe Dukat.

Gjithashtu është distributor ekskluziv i markave të njohura rajonale dhe ndërkombëtare si Cremona, Bonizzi, Jaffa, Nom, Estrella Damm, Heymans, Komos Tequila, The London Essence, Bylmeti etj.

Aktualisht në kuadër të zgjerimit të departamentit tonë të Blerjeve jemi duke kërkuar një **Menaxher Blerje** me bazë në **Tiranë**

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Protokollimi i blerjeve në kohë dhe me saktësi;
- Përpilimi i grafikut të blerjeve, monitorimi i progresit dhe hartim i një plani të rifreskuar;
- Kërkime dhe vlerësime mbi furnitorët, bazuar mbi çmimin, cilësinë, përzgjedhjen, shërbimin, mbështetjen, gatishmërinë, besimin, prodhimin dhe kapacitetet e shpërndarjes, si dhe emri dhe historia e furnitorit;
- Analizimi i çmimeve të propozuara, raportimeve financiare dhe çdo të dhënë dhe informacion tjetër, për të përcaktuar çmimin më të mirë;
- Negocion, rinegocion dhe administron kontratat me furnitorët, vendorët dhe përfaqësues të tjerë;
- Monitoron ngarkesat për t'u siguruar që mallrat/pajisjet vijnë në kohë dhe për të zgjidhur problemet përkatëse me mallrat/pajisjet e padërguara;
- Komunikon statusin e porosive me ndihmën e fabrikës për t'u siguruar se janë zbatuar grafikët/afatet;
- I lokalizon furnitorët e materialeve/pajisjeve dhe i interviston ata për të përcaktuar disponueshmërinë e produktit dhe kushtet e shitjeve;
- Ndihmon në kontrollimin e buxhetit të departamentit të blerjeve;
- Ndihmon në hartimin dhe rishikimin e neneve të kontratave të porosive të blerjeve, në përshtatje me politikat e kompanisë;
- Mbikqyr dhe analizon tregun dhe sistemet e dërgesave për të vlerësuar disponueshmërinë e materialeve/pajisjeve aktualisht dhe në të ardhmen;
- Zhvillon dhe zbaton udhëzimet e Administratorit, politikat dhe procedurat e shoqërisë;
- Përgatit dhe mban një bazë të dhënash për të gjithë furnitorët dhe nënkontraktorët;
- Kryen funksione të tjera të përcaktuara nga Administratori i Përgjithshëm.

Kualifikimet e kërkuara për pozicionin:

- Diplomë Universitare në Menaxhim Biznesi apo fusha të ngjashme.
- Eksperience pune në pozicione të ngjashme jo më pak se 3 vjet.

- Aftësi të shkëlqyera organizative, duke përfshirë aftësi për të planifikuar punën dhe vendosur prioritete;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, të zotërojë etikë pune dhe integritet;
- Njohuri të mira të gjuhës Angleze;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike, sidomos paketat MS Office;
- Patente të vlefshme drejtimi.

Për të aplikuar, ju lutemi dërgoni **CV-në tuaj** në adresën email hr@lufra.al me subjektin "Aplikim për Menaxher Logjistike". Afati i fundit për aplikim është dt.**20 Dhjetor 2023**.